

Lista e marrëveshjeve dhe vendimeve të nënshkruara nga kryetari i Komunës **Bali MUHARREMAJ** - Janar 2021

| Nr. | Emri i vendimit                                                                                                             | Numri i protokolit |
|-----|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| 1   | Vendim për menagjer të kontratës - furnizim me material administrativ-shëndetësor                                           | 01-016-3089        |
| 2   | Vendim - Sale Bytyqi UD caktohet menagjere e kontratës – paisje mjekësore                                                   | 01-016-3092        |
| 3   | Marrëveshje 3 palëshe bashkëpunimi në mes të Komunës së Suharekës – Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit dhe Eko-Regjionit | 01-016-2440        |
| 4   | Marrëveshje mirëkuptimi –rregullimi i shtratit të lumit Toplluha Ministria e Ambientit-Komuna e Suharekës                   | 01-016-2445        |
| 5   | Vendim për formimin e komisionit për regjistrimin e arkës dhe stokut në Komunë                                              | 01-016-3082        |
| 6   | Vendim për menagjer të kontratës - Zhvillimi i turizmit lokal                                                               | 01-016-3094        |
| 7   | Vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave (taksë në aktivitet) në DEBF                                     | 01-410-3273        |
| 8   | Aktvendim për lejimin e mjeteve financiare për drejtorinë e Kulturës                                                        | 01-400-11758       |
| 9   | Autorizim për shoferin e kryetarit Musli Kuqi për punë jashtë orarit dhe në festa                                           | 01-016-4294        |
| 10  | Aktvendim për furnizim me derivate                                                                                          | 01-400-5133        |
| 11  | Aktvendim për furnizim me derivate                                                                                          | 01-016-6011        |
| 12  | Memorandum Mirëkuptimi në mes të Agjencisë së Kosovës për Eficiencë të Energjisë dhe Komunës së Suharekës                   | 01-016-5381        |
| 13  | Autorizim –Afrim Bytyqi UD- shef i Prokurimit për lidhje online ZOOM për shqyrtim të ankesës në OSHP                        | 01-016-6396        |
| 14  | Autorizim –Afrim Bytyqi UD- shef i Prokurimit                                                                               | 01-016-6870        |



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E SUHAREKËS  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 016-3089

Me date: 13.01.2021

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në pajtim me nenin 59 dhe 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Nr.05/L-031, nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekë 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008si dhe Rregullave dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik/A01, nxjerrë këtë:

V E N D I M

**Sale Bytyqi, U.D. Drejtor i QKMF-së, Suharekë caktohet Menaxher i Kontratës:** “Furnizimi me material administrative-Shëndetësor. Me nr.të prokurimit 624-20-8433-1-3-6/624-020-115-136.

- I. Menaxheri obligohet të hartoj një plan të dakorduar midis palëve të kontrates dhe i cili duhet të nënshkruhet nga ana e tyre para inicimit të zbatimit të kontratës.
- II. Plani ka për qëllim menaxhimin e kësaj kontrate, duke përfshirë në veçanti çështjet e aspekteve organizative, ekonomike, teknike dhe ligjore të menaxhimit të kontratës.
- III. Plani i Menaxhimit të kontratës është dokument i cili do të përtërihet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në Kontratë origjinale.
- IV. Menaxheri i kontratës e menaxhon kontratën deri në pranimin e plotë të [artikujve/shërbime/punëve] të kërkuar respektivisht deri në përmbylljen e saj.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Bali MUHARREMAJ

Kryetar i Komunës

Dergohet:

-Menaxherit të projektit,

- Arkivi





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E SUHAREKËS  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 016-3092

Me date: 13.01.2021

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në pajtim me nenin 59 dhe 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Nr.05/L-031, nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008si dhe Rregullave dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik/A01, nxjerrë këtë:

V E N D I M

**Sale Bytyqi, U.D. Drejtor i QKMF-së, Suharekë** caktohet **Menaxher i Kontratës**: “ Paisje Mjekësore” vazhdim. Me nr.të prokurimit 624-20-6547-1-2-1/624-020-127-121.

- I. Menaxheri obligohet të hartoj një plan të dakorduar midis palëve të kontrates dhe i cili duhet të nënshkruhet nga ana e tyre para inicimit të zbatimit të kontratës.
- II. Plani ka për qëllim menaxhimin e kësaj kontrate, duke përfshirë në veçanti çështjet e aspekteve organizative, ekonomike, teknike dhe ligjore të menaxhimit të kontratës.
- III. Plani i Menaxhimit të kontratës është dokument i cili do të përtërihet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në Kontratë origjinale.
- IV. Menaxheri i kontratës e menaxhon kontratën deri në pranimin e plotë të [artikujve/shërbime/punëve] të kërkuar respektivisht deri në përmbylljen e saj.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Bali MUHARREMAJ

Kryetar i Komunës

Dergohet:

-Menaxherit të projektit,

- Arkivi



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
 REPUBLIC OF KOSOVO  
 QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT  
 MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT  
 MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE  
 MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT

Mëdalla Org.  
Org. Jedini  
Org. Unit

Nr. i fletëve  
Broj stranica  
No. pages

01

51

7

13.01.2021

PRISHTINE/A

NO.1



m.03

13.01.2021

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS  
 REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUHAREKA  
 REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

MARRE NË DORËZIM - PRIMLJENO - RECEIVED

| Nëlia org.<br>Org. Jedinica<br>Org. Unit | Numri<br>Broj<br>Number | Shtojca<br>Prilog<br>Appendix | Vlera<br>Vrednost<br>Value |
|------------------------------------------|-------------------------|-------------------------------|----------------------------|
| 01                                       | 016                     | 2440                          | 7                          |

Republika e Kosovës  
 Republika Kosova-Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit  
 Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine  
 Ministry of Economy and Environment

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra /Kabinet of the Ministër

MARRËVESHJE (TREPALËSHE) BASHKËPUNIMI

E LIDHUR

NË MES TË

MINISTRISË SË EKONOMISË DHE AMBIENTIT

KOMUNËS SË SUHAREKËS

DHE

KRM "EKO REGJIONI" sh.a

Prishtinë, 2021

Në mbështetje të nenit 10 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjensive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7/1 Mars 2019, duke u bazuar në nënin 8 të Rregullores (QKR), Nr. 06/2020 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Rregullorën (QKR) Nr.m 07/2020 për Plotsimin dhe Ndryshimin e Rregullorës (QKR) Nr 06/2020, në nenin 5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), si dhe Ligjin Nr 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, palët nënshkruese lidhin këtë:

## **MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT**

**Mirëmbajtja e hapësirave të veçanta publike në Komunën e Suharekës**

### **Palët Nënshkruese**

1. Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit e përfaqësuar nga Ministri i MEA-së, z. Blerim Kuçi (në tekstin e mëtejme MEA);
2. Komuna e Suharekës e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, z. Bali Muharremaj (në tekstin e mëtejme Komuna), si dhe;
3. KRM "Eko Regjioni" sh.a Prizren, më përfaqësues z. Nehat Basha, (në tekstin e metejme Kompania Rajonale e Menaxhimit të Mbeturinave).

### **Neni 1**

### **Qëllimi**

Qëllimi i këtij Memorandumi është financimi i projektit "Mirëmbajtja e hapësirave të veçanta publike në Komunën e Suharekës". Ky projekt përfshinë mirëmbajtjen, vendosjen e paisjeve të mbeturinave sipas standardeve, vendosjen e kushteve për mirëmbajtje të rregullt dhe funksionale të hapësirave të veçanta publike.

## **Neni 2**

### **Vlera e projektit dhe mënyra e Bashkëfinancimit**

- 1.MEA financon këtë projekt në vlerë prej: 100,000.00 € në vitin fiskal 2021 nga kod 0630 213165-2137845 18878 01.2021-12.2021 Projektet Kapitale me bashkefinancim ne sektorin e ujrave dhe mbeturinave ne bashkepunim me NP-te, programi 213165 - Njësia për Politika dhe Monitorimin e NP, nënprogrami 22500 - Uji dhe Hedhurinat".
- 2.Komuna e Suharekës do të financojë këtë projekt në vlerë prej 20,000.00 € për vitin 2021.
- 3.KRM "Eko Regjioni" sh.a Prizren, do të financojë projektin në vlerën prej 10,000.00 € për vitin 2021.

## **Neni 3**

### **Obligimet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit**

- 1.MEA-ja i zotën mjetet për projektin nga neni 2 i kësaj Marrëveshje dhe një kopje e dërgon në Komunën e Suharekës.
- 2.Pagesat për bashkëfinancimin e projektit "Mirëmbajtja e hapësirave të veçanta publike në Komunën e Suharekës" nga MEA dhe , do të bëhen në pajtim me kërkesat e Komunës së Suharekës në përputhje me punët e kryera sipas dëshmive përkatëse.
- 3.MEA cakton një zyrtar monitorues lidhur me këtë projekt, i cili monitoron projektin nga fillimi deri në përfundim të kontratës dhe në momentin kur i vëren parregullsitë apo defektet gjatë realizimit të kontratës njofton menaxhmentin e MEA-së.

#### Neni 4

##### Obligimet e KRM Eko Regjioni sh.a.

1. KRM Eko Regjioni sh.a. obligohet që të krijoj kushtet e nevojshme për realizimin e projektit "Mirëmbajtja e hapësirave të veqëanta publike në Komunën e Suharekës" gjatë kryerjes së punimeve dhe ndërmerrë të gjitha masat e nevojshme që pa pengesa të filloj implementimi i projektit më kohë.
2. KRM Eko Regjioni sh.a duhet të ndërmerr të gjitha masat që shuma e buxhetit e ndare për këtë projekt sipas nenit 2. të kësaj marrveshje, të realizohet gjatë vitit buxhetor 2021.
3. KRM Eko Regjioni sh.a merr për obligim që të ofroj ndihmë teknike dhe profesionale gjatë gjithë fazës së implementimit të projektit.

#### Neni 5

##### Obligimet e Komuna e Suharekës

1. Komuna e Suharekës, obligohet që t'i krijoj kushtet e nevojshme për realizimin e projektit "Mirëmbajtja e hapësirave të veqëanta publike në Komunën e Suharekës" për operatorin ekonomik, të ndërmerr të gjitha masat që kontraktuesi pa pengesa të filloj implementimin (furnizimin) e projektit me kohë si dhe të siguroj specifikacionin teknik.
2. Komuna obligohet që projektin "Mirëmbajtja e hapësirave të veqëanta publike në Komunën e Suharekës" realizoj në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 e Prokurimit Publik dhe të Ligjit Nr. 04/L-194 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe aktet nënligjore për zbatimin e këtyre ligjeve.
3. Komuna e Suharekës e kryen procesin e tenderimit, cakton komisionin e hapjes dhe vlerësimit të tenderit.

4. Komuna e Suharekës, emëron projekt menaxherin/organin mbikëqyrës për realizimin e projektit si dhe për inspektimin final të punimeve/pranimin teknik.
5. Projekt menaxheri/organi mbikëqyrës me përgjegjësi të plotë vërteton sasinë dhe kualitetin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për pagimin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të kushteve të kontratës dhe i raporton njesisë së prokurimit të Komunës së Suharekës.
6. Komuna e Suharekës obligohet që të njoftoj KRM Eko-Regjioni sh.a. si dhe MEA-në për çdo propozim ndryshim eventual të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projektit, dhe për këtë të kërkoj pëlqimin e tyre.
7. Komuna e Suharekës obligohet që për të realizuar pagesat për punët/furnizimet e kryera në nivel të financimit nga ana e KRM Eko Regjioni sh.a. dhe MEA -së, të kompletoj këto dokumente:
  - 7.1. Procesverbalin e hapjes së tenderit dhe raportin e vlerësimit të tenderit (si dhe në rastet e korigjimit të çmimeve të dorëzohen dokumentet e korigjuara).
  - 7.2. Kopjen e Kontratës të nënshkruar me operatorin ekonomik së bashku me ofertën financiare, të verifikuar nga përgjegjësi.
  - 7.3. Vendimi mbi emërimin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionin e pranimi.
  - 7.4. Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionit të pranimi mbi punët/furnizimet e kryera dhe të aprovuara (situacionet e aprovuara).
  - 7.5. Faturën origjinale nga operatori ekonomik.
  - 7.6. Kopjen e certifikatës së biznesit, llogarinë bankare dhe letërnjoftimin e pronarit të operatorit ekonomik (nëse nuk është i regjistruar në SMIFK-Departamenti i Thesarit-Ministria e Financave).
8. Komuna e Suharekës, duhet të ndërmerret të gjitha masat që shuma e buxhetit e ndarë për këtë projekt sipas nenit 2.1 të kësaj marrëveshje, të realizohet gjatë vitit buxhetor 2020/2021.
9. Komuna e Suharekës, është e obliguar të njoftoj KRM Eko Regjioni sh.a. dhe MEA për rrjedhat e realizimit të projektit sipas progresit të punimeve deri në përfundim të projektit.

## **Neni 6**

### **Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes së Mirëkuptimit**

1.Me pëlqimin paraprak të Ministrit të MEA -së, Kryetarit të Komunës, si dhe KRM Eko Regjioni sh.a. marrëveshja mund të ndryshohet dhe plotësohet.

2. MEA -ja dhe KRM Eko Regjioni sh.a.mbanë të drejtën e ndërprerjes së shfrytëzimit të buxhetit për këtë destinim në rast së konstaton se Komuna e Suharekës nuk i ka përmbushur obligimet e veta të dala nga kjo Marrëveshje.

## **Neni 7**

### **Zgjidhja e marrëveshjes**

Palët janë pajtuar në mes vete që kjo marrëveshje të zgjidhet më mirëkuptim.

## **Neni 8**

### **Numri i kopjeve**

Marrëveshja e Mirëkuptimit është nënshkruar në tri (3) kopje, nga një kopje për secilën palë nënshkruese.

## **Neni 9**

### **Pronësia e projektit**

Me pranim dorëzimin e punëve të kryera, ky investim (projekt) nga kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit do kaloj në menaxhim të KRM Eko Regjioni sh.a..

## **Neni 10**

### **Hyrja në fuqi**

1. Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje e mirëkuptimit të fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

Datë, 13 / 01 / 2021



**Blerim Kuri**  
**Ministër i MEA-së**

**Bali Muharremaj,**  
**Kryetar i Komunës së Suharekës**



**Nehat Basha**  
**KRM "Eko Regjioni" sh.a.**

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA /  
 REPUBLIC OF KOSOVO  
 QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT  
 MINISTRIA E EKONOMISE DHE AMBIENTIT  
 MINISTARSTVO EKONOMIJE I ZIVOTNE SREDINE  
 MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT

Nr. Prot. 01  
 Nr. Prot. 49  
 Data: 13.01.21  
 Data: 13.01.21

Nr. i faqes 5  
 Broj stranica 5  
 No. pages 5

PRISHTINE A NO.1

nr. 01



13-01-2021

REPUBLICA E KOSOVES - KOMUNA E SUHAREKES  
 REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA SUVA REKA  
 REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

MARRË NË DORËZIM PRIMLJENO - RECEIVED

| Nësisë org.<br>Org. Jedinica<br>Org. Unit | Numri<br>Broj<br>Number | Shtojca<br>Prilog<br>Appendix | Vlera<br>Vrednost<br>Value |
|-------------------------------------------|-------------------------|-------------------------------|----------------------------|
| 01                                        | 016                     | 2445                          | ±                          |

Republika e Kosovës  
 Republika Kosova-Republic of Kosovo  
 Qeveria -Vlada-Government  
 Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit  
 Ministarstvo ekonomije i životne sredine  
 Ministry of Economy and Enviroment

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI/BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

MINISTRISË SË EKONOMISË DHE AMBIENTIT

DHE

KOMUNËS SË SUHAREKËS

Prishtinë 2021

Lumi Toplluha

Në mbështetje të nenit 10 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjensive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7/1 Mars 2019, duke u bazuar në nënin 8 të Rregullores (QKR), Nr. 06/2020 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Rregullorën (QKR) Nr.m 07/2020 për Plotsimin dhe Ndryshimin e Rregullorës (QKR) Nr 06/2020, në nenin 5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), si dhe Ligjin nr. 07/l-014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit me nr.07/l-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, palët nënshkruese lidhin këtë:

## **MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT**

### **Rregullimi i shtratit të lumit Toplluha – Suharekë**

#### **Palët Nënshkruese**

1. Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit e përfaqësuar nga Ministri i MEA-së (në tekstin e mëtejme MEA),

dhe

2. Komuna e Suharekës e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, (në tekstin e mëtejme Komuna),

#### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i këtij Memorandumi është financimi i ndërtimit rezervuarit të ujit të pijës në lokacionin Pusi i Atit, në Komunën e Suharekës.

#### **Neni 2 Vlera e projektit dhe mënyra e Bashkëfinancimit**

1. MEA financon këtë projekt në vlerë prej: 250,000.00 € në vitin fiskal 2021, nga nënprogrami Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore, kodi buxhetor 15795, Kategoria Projekte Kapitale për vitin fiskal 2021 dhe vlerën prej 250,000.00 € për vitin fiskal 2022.
2. Komuna e Suharekës do të financojë vlerën shtesë të projektit.

8. Komuna obligohet që për të realizuar pagesat për punët/furnizimet e kryera në nivel të financimit nga ana e MEA -së, të kompletoj këto dokumente :

8.1 Procesverbalin e hapjes së tenderit dhe raportin e vlerësimit të tenderit (si dhe në rastet e korrigjimit të çmimeve të dorëzohen dokumentet e korrigjuara).

8.2 Kopjen e Kontratës të nënshkruar me operatorin ekonomik së bashku me ofertën financiare, të verifikuar nga origjinali prej menaxherit të prokurimit të komunës.

8.3 Vendimi mbi emërimin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionin e pranimi nga ana e Komunës.

8.4 Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionit të pranimi mbi punët/furnizimet e kryera dhe të aprovuara (situacionet e aprovuara).

8.5 Faturën origjinale nga operatori ekonomik deri në lartësinë e shumës së financuar nga MEA.

8.6 Kopjen e certifikatës së biznesit, llogarinë bankare dhe letërnjoftimin e pronarit të operatorit ekonomik (nëse nuk është i regjistruar në SMIFK-Departamenti i Thesarit-Ministria e Financave).

9. Komuna duhet të ndërmerr të gjitha masat që shuma e buxhetit e ndare për këtë projekt sipas nenit 2.1 të kësaj marrëveshjeje, të realizohet gjatë vitit buxhetor 2021.

10. Komuna është e obliguar të njoftoj MEA për rrjedhat e realizimit të projektit sipas progresit të punimeve deri në përfundim të projektit.

## **Neni 5**

### **Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes së Mirëkuptimit**

1.Me pëlqimin paraprak të Ministres së MEA -së dhe Kryetarit të Komunës, marrëveshja mund të ndryshohet dhe plotësohet.

2. MEA -ja mbanë të drejtën e ndërprerjes së shfrytëzimit të buxhetit për këtë destinim në rast se konstaton se Komuna nuk i ka përmbushur obligimet e veta të dala nga kjo Marrëveshje.

**Neni 6**  
**Zgjidhja e marrëveshjes**

Palët janë pajtuar në mes vete që kjo marrëveshje të zgjidhet me mirëkuptim.

**Neni 7**  
**Numri i kopjeve**

Marrëveshja e Mirëkuptimit është nënshkruar në dy kopje, nga një kopje për secilën palë nënshkruese.

**Neni 8**  
**Pronësia e projektit**

1. Me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga ana e operatorit ekonomik, ky investim (projekt) nga kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit do kaloj në pronësi të Komunës.
2. Ky investim regjistrohet në pronësi të komunës në mënyrë elektronike dhe fizike, në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK).

**Neni 9**  
**Hyrja në fuqi**

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje e mirëkuptimit të fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E SUHAREKËS  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E KRYETARIT

01-Nr. 016-3082

Me date: 15.01.2021

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 e lidhur me nenin 62, pika 1 të ligjit 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 28/2008, nenit 44, të Ligjit Nr-05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative < Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-20/2016, Kryetari i Komunës në Suharekë, nxjerr këtë :

## VENDIM

- I. Formohet komisioni për regjistrimin e arkës dhe stokut me gjendjen që përfundon me 31.12.2020 të komunës së Suharekës në këtë përbërje:
- 1.1 Rexhep Manxhuka.....Kryesues  
1.2 Shqipe Bytyçi .....Anëtare  
1.3 Afërdita Kallaba.....Anëtare
- II. Detyrat e këtij komisionit është të bëj regjistrimin e arkës dhe stokut me gjendjen që përfundon me datën 31.12.2020 së komunës së Suharekës dhe të paraqesin raportin tek Drejtori i drejtorisë për ekonomi, financa dhe buxhet ndërsa për gjendjen fizike të stokut (materiale shkresore etj.) të dorëzohet raporti edhe tek Zyrtari për menaxhimin e pasurisë.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe shfyqizon Vendimin me nr. të prot. 01-Nr.020-84136, të datës 26.12.2019.

Të njoftohen:

- Anëtarët e komisionit
- Arkiva

Kryetari i Komunës  
Bali Muharemaj



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E SUHAREKËS  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



**ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS**

01-Nr. 016-3094

Me date: 15.01.2021

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në pajtim me nenin 59 dhe 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Nr.05/L-031, nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008si dhe Rregullave dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik/A01, nxjerrë këtë:

**V E N D I M**

**Xhevxhet Gashi, Drejtor i DBZHRP** caktohet **Menaxher i Kontratës**: “ Zhvillimi i turizmit rural – hapja e rrugëve malore në Dolloc – Vazhdim. Me nr.të prokurimit 624-20-6859-5-2-1/624-020-135-521.

- I. Menaxheri obligohet të hartoj një plan të dakorduar midis palëve të kontrates dhe i cili duhet të nënshkruhet nga ana e tyre para inicimit të zbatimit të kontratës.
- II. Plani ka për qëllim menaxhimin e kësaj kontrate, duke përfshirë në veçanti çështjet e aspekteve organizative, ekonomike, teknike dhe ligjore të menaxhimit të kontratës.
- III. Plani i Menaxhimit të kontratës është dokument i cili do të përtërihet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në Kontratë origjinale.
- IV. Menaxheri i kontratës e menaxhon kontratën deri në pranimin e plotë të [artikujve/shërbime/punëve] të kërkuar respektivisht deri në përmbylljen e saj.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe shfuqizon Vendimin me nr. Të prot. 01-Nr.016-61697, të dates 23.12.2020.

Dergohet:

-Menaxherit të projektit,

- Arkivi



Bali MUHARREMAJ

Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E SUHAREKËS  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E KRYETARIT

01-Nr. 10-224

Me date: 15.01.2021

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 e lidhur me nenin 62, pika 1 të ligjit 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 28/2008, nenit 44, të Ligjit Nr-05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative < Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-20/2016, Kryetari i Komunës në Suharekë, nxjerr këtë :

## VENDIM

- I. Formohet komisioni për shqyrtimin e ankesave administrative lidhur me pakënaqësinë që paraqiten ndaj vendimeve të sektorit për ekonomi dhe financa pranë DEBF-së përkatësisht (taksës në aktivitet) në këtë përbërje:
- 1.1 Ismajl Bytyçi.....Kryesues  
1.2 Nazim Elshani .....Anëtar  
1.3 Urim Fondaj.....Anëtar
- II. Detyrat e këtij komisionit është të shqyrton dhe vendos lidhur me ankesat administrative lidhur me pakënaqësitë që paraqiten ndaj vendimeve të sektorit për ekonomi dhe financa në Drejtorinë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe shfaqet  
Vendimin me nr. të prot. 01-Nr.016-45382, të datës 23.09.2020.

Të njoftohen:

-Anëtarët e komisionit

- Arkiva



Kryetari i Komunës

Bah Muharremaj



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E SUHAREKËS  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



**ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS**

01-Nr. h00-11758

Me date: 16.01.2021

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.-03/L-040, nenit 30 dhe 45, të Statusit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, neni 44 të Ligjit për procedure administrative numër Nr -02-/ L-28, Kryetari i Komunës së Suharekës, merr këtë:

**AKTVENDIM**

Për lejimin e mjeteve financiare

- I. Lejohen mjete financiare në vlerë prej 150.00 Euro (Njëqind e Pesëdhjetë euro dhe Zero cent) në emër të Hotel "Rozafa", me seli në Suharekë. Mjetet lejohen nga programi Mallra dhe Shërbime të Drejtorisë për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë.
- II. Për zbatimin e këtij aktvendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa
- III. Ky aktvendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Suharekës

**Arsyetim**

Duke u bazuar në raportin nga Drejtorisë për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë, të datës 11.02.2021, ku sipas saj, janë pritur me drekë pune nxënësit e shkollës së mesme teknike "Skender Luarasi" për dekorimin e qytetit për festat e fundvitit. Andaj dhe kërkohet të lejohen mjete financiare në vlerë prej 150.00 Euro (Njëqind e Pesëdhjetë euro dhe Zero cent) në emër të Hotel "Rozafa", me seli në Suharekë. Mjetet lejohen sipas faturave, me nr. 10Nr. 14, të datës 09.02.2021 nga programi Mallra dhe Shërbime të Drejtorisë për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendim

Të njoftohen:  
-DEBF  
-Arkiva



Kryetari i Komunës  
*Bali Muharremaj*  
**Bali MUHARREMAJ**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E SUHAREKËS  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr. 016- 4294

Me date: 20.01.2021

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.-03/L-040, nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, Kryetari i Komunës së Suharekës, merr këtë:

**AUTORIZIM**

Autorizohet **Musli Kuqi nga Suhareka** ( shofer në aktivitetet e Kryetarit ) , që të punon çdo herë që paraqitet nevoja jashtë orarit të punës, ditëve të vikendit dhe festave zyrtare për përcjelljen e aktiviteteve të Kryetarit.

Autorizimi nuk mund të shërbejë për qëllime tjera.



Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ

Të njoftohen:

- Arkiva
- pala



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E SUHAREKËS  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



**ZYRAE KRYETARIT TË KOMUNËS**

01-Nr. 400-5133

Me date: **22.01.2021**

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.-03/L-040, nenit 30 dhe 45, të Statusit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, neni 44 të Ligjit për procedure administrative numër Nr -05-/ L-031, Kryetari i Komunës së Suharekës, merr këtë:

**AKTVENDIM**

- I. Lejohen 100 l (litra) derivate – naftë për z. Hyzer Suka nga fshati Bllacë, derivatet lejohen nga Drejtoria për Administratë.
- II. Për zbatimin e këtij aktvendimi kujdeset Drejtoria për Administratë
- III. Ky aktvendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Suharekës

**Arsyetim**

Duke u bazuar në gjendjen aktuale të vërshimeve nga reshjet atmosferike, të cilat kanë ndodhur nga 08-11 Janar 2021 dhe në vullnetin e lirë të z. Hyzer Suka nga fshati Bllacë i lejohen 100 l (lita) derivate – naftë për rregullimin-pastrimin e rrugëve lokale.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

Të njoftohen:

-DEBF  
-Arkiva

*Derguar 25.01.2021*  
*Musli Kuci*



**Kryetari i Komunës**

**Baki MUHARREMAJ**



**ZYRAE KRYETARIT TË KOMUNËS**

01-Nr. 016-6011

Me date: 25.01.2021

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.-03/L-040, nenit 30 dhe 45, të Statusit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, neni 44 të Ligjit për procedure administrative numër Nr -05-/ L-031, Kryetari i Komunës së Suharekës, merr këtë:

**AKTVENDIM**  
**(Për furnizim me derivate)**

- I. Lejohen derivate – naftë sipas listës më posht:
  - 1.1 Enver Gashi, Leshan – 200 litra
  - 1.2 Xhavit Baraliu, Bukosh – 100 litra
  - 1.3 Fadil Hoxha, Samadrexhë – 100 litra
  - 1.4 Zaim Buqa, Budakovë 100 litra , derivatet lejohen nga Drejtoria për Administratë.
- II. Për zbatimin e këtij aktvendimi kujdeset Drejtoria për Administratë
- III. Ky aktvendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Suharekës

**Arsyetim**

Duke u bazuar në gjendjen aktuale të vërshimeve nga reshjet atmosferike, të cilat kanë ndodhur nga 08-11 Janar 2021 dhe në vullnetin e lirë të persona të lartëcekur iu lejohen derivate – naftë për rregullimin-pastrimin e rrugëve lokale.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Të njoftohen:

-DEBF  
-Arkiva



Kryetari i Komunës

**Bali MUHARREMAJ**

nr. 5



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA /  
REPUBLIC OF KOSOVO  
GOVERIA - VLAJA - GOVERNMENT  
MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT  
MINISTRI OF ECONOMY AND ENVIRONMENT

01/2  
4  
166  
20.01.2021  
PRISHTINE A



25.01.2021

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS  
REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUHAREKA  
REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

MARRË NË DORËZIM - PRIMLJENO - RECEIVED

| Nësimi org.<br>Org. Jedinica<br>Org. Unit | Numri<br>Broj<br>Number | Shtojca<br>Prilog<br>Appendix | Vlera<br>Vrednost<br>Value |
|-------------------------------------------|-------------------------|-------------------------------|----------------------------|
| 01                                        | 016                     | 5381                          | ?                          |

## MEMORANDUM MIRËKUPITIM

### NDËRMJET

## AGJENCISË SË KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË

### DHE

### KOMUNËS SË SUHAREKËS

### Për zbatimin e Pilot Projektit

### "Promovimi i Eficiencës së Energjisë në nivel lokal përmes zbatimit të masave të Eficiencës së Energjisë"

PRISHTINË, 2021

## **NENI 1**

### **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është të sigurohet bashkëpunimi i dakorduar dhe i ngushtë midis palëve nënshkruese në implementimin e pilot projektit “Promovimi i Eficiencës së Energjisë në nivel lokal përmes zbatimit të masave të Eficiencës së Energjisë”, duke përdorë sistemin eficient të ndriçimit.

## **NENI 2**

### **Baza ligjore**

Ky projekt është në pajtim të plotë me zbatimin e Planit Nacional për Eficiencë të Energjisë, dhe është vazhdim i bashkëpunimit në fushën e promovimit të eficiencës në mes të Ministrisë dhe Komunave të Kosovës e që kontribuon në përmbushjen e obligimeve të Kosovës ndaj Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE).

## **NENI 3**

### **Përgjegjësitë e Palëve**

1. Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë do të kontribuoj si në vijim:

- 1.1 Menaxhimi dhe koordinimi i përgjithshëm i projektit, duke përfshi organizimin e takimeve për progresin e projektit dhe konsultimet e nevojshme.
- 1.2 Ofrimi i përkrahjes financiare në vlerë prej € 140,800.00 (njëqind e katërdhjet mijë e tetëqind Euro) ndaj Komunës së Suharekës nga këto dy kode 15372 Programi i zbatimit të masave të EE dhe 18364 Zbatimi i masave të EE dhe BRE në Qendren për Ekselenc Digjitale në ITP – Prizren, pagesë e cila do të përmbillet brenda tri viteve ndaj Komunës.
- 1.3 Prezantimi i rezultateve tek njësia kërkuuese dhe agjencitë tjera qeveritare, si dhe tek akterët tjerë.
- 1.4 Mbikëqyrja e progresit të projektit

2. Komuna e Suharekës do të kontribuoj si në vijim:

- 2.1 Menaxhimi dhe koordinimi i projektit,
- 2.2. Bashkë-financimi i projektit në shumën prej € 35,200.00 (tridhjet e pesëmijë e dyqind Euro) në periudhën tre vjeçar

3. Prezantimi i rezultateve të projektit në Kolegjiumin e Drejtorëve të Shërbimeve Publike, Asociacionin e Komunave të Kosovës si dhe ministritë përkatëse e akterët tjerë,

4. Përpilimin i raportit përfundimtar brenda dy javëve pas përfundimit të projektit

#### **NENI 4**

##### **Menaxhimi dhe Mbikqyrja e Projektit**

1. Palët nënshkruese pajtohen që të emërojnë një Menaxher të kontratës për mbikëqyrjen e implementimit të projektit, sa i përket transparencës dhe kualitetit të punimeve, në përputhje me dokumentacionin dhe brenda kornizës buxhetore.
2. AKEE do të jetë përgjegjës për procedurat e prokurimit, menaxhimin e tenderit dhe kontratës sipas Ligjit të Prokurimit Publik të aplikueshëm, përfshirë nënshkrimin e kontratës me ofertuesin e suksesshëm.
3. AKEE dhe Komuna e Suharekës do të pajtohen për procedurat e pagesave për palën e kontraktuar për kryerjen e punimeve si dhe atë të mbikëqyrjes bazuar në kushtet e kontratës.
4. AKEE dhe Komuna e Suharekës pajtohen të zhvillojnë një plan zbatues Brenda një jave pas nënshkrimit të MeM.
5. AKEE dhe Komuna e Suharekës do të komunikojnë rregullisht me njëra tjetrën për të koordinuar aktivitetet që lidhen me këtë marrëveshje.
6. Palët e nënshkruara sigurojnë që personat të cilët janë të angazhuar në përgatitjen dhe implementimin e masave të specifikuara në Marrëveshjen e Mirkuptimit dhe nënshkrimin e kontratës për furnizim dhe shërbime të cilat do të financohen, nuk do të kërkojnë, pranojnë, apo të marrin premtim për pagesë të ndonjë shume ilegale apo ndonjë përfitim të llojit tjetër në lidhje me këto detyra.

#### **NENI 5**

##### **Ndryshimi i Marrëveshjes**

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e nënshkruesve të Marrëveshjes.

#### **NENI 8**

##### **Hyrja në fuqi**

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje të zbatohet nga dita e nënshkrimit të saj.

Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë

Komuna e Suharekës

**Z. Arsim Kuliqi**



**Kryeshet Ekzekutiv**

Prishtinë, më 19/10/2021

**Z. Bali Muharemaj**



**Kryetar i Komunës**

Prishtinë, më 25/10/2021

**KRYETARI I KOMUNËS**01-Nr- 016-6396

Më datë 27.01.2021

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58, të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetqeverisje Lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-2008/28, Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

**Autorizim**

**Autorizohet z. Afrim Bytyqi u.d shëf i prokurimit** që të përfaqësoj Ak- Komuna e Suharekës, me dt : 27.01.2021 në orën 10:30 përmes platformës ZOOM nga OSHP do të mbahet seanca online për shqyrtim kryesor të ankesës nr.13/21

Ky autorizim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe vlenë deri në përfundimin e kësaj procedure.

**I dërgohet**

Punëtorit

Arkiva

**Kryetari i Komunës**  
  
**Baki Muharremaj**



**KRYETARI I KOMUNËS**

01-Nr-016-6870

Më datë 28.01.2021

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58, të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetqeverisje Lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-2008/28, Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

**Autorizim**

**Autorizohet z. Afrim Bytyqi u.d shëf i prokurimit** që të përfaqësoj Ak- Komuna e Suharekës, Me dt : 28.01.2021 në orën 12:00 përmes platformës ZOOM nga OSHP do të mbahet seanca online për shqyrtim kryesor të ankesës nr.1176/20-16/21

Ky autorizim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe vlenë deri në përfundimin e kësaj procedure.

I dërgohet

Punëtorit

Arkiva

